

# BULETINI



**KOMUNA E LIPJANIT**  
**MARS 2026**

# NËNKRYETARI BYTYQI NËNSHKRUAN MARRËVESHJE PËR MBËSHTETJEN E GRAVE NË NDËRMARRËSI

Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, ka pritur në takim përfaqësuesen e Fondacioni Jahjaga, znj. Arlinda Zaimi, me të cilën ka nënshkruar Marrëveshje Mirëkuptimi për bashkëfinancimin e projektit “Gratë në Agrikulturë”, me qëllim mbështetjen e ndërmarrësisë dhe trajnimeve profesionale për gratë në Komunën e Lipjanit.

Me këtë rast Nënkryetari Bytyqi, theksoi se mbështetja e grave në ndërmarrësi mbetet prioritet institucional.

“Komuna e Lipjanit mbështet çdo marrëveshje dhe iniciativë që ka për qëllim fuqizimin ekonomik të grave dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Ky projekt ofron mundësi konkrete për zhvillimin profesional të grave dhe rritjen e pavarësisë së tyre ekonomike”, tha Nënkryetari z. Diamant Bytyqi.

Përfaqësuesja e Fondacionit Jahjaga, znj. Arlinda Zaimi, falënderoi Komunën e Lipjanit për bashkëpunimin dhe mbështetjen në realizimin e këtij projekti, duke theksuar rëndësinë e partneritetit institucional në krijimin e mundësive të reja për gratë ndërmarrëse.

Projekti synon fuqizimin socio-ekonomik të grave përmes ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe ofrimit të mbështetjes konkrete. Programi përfshin trajnim teorik dhe praktik, të hartuar sipas nevojave dhe aftësive individuale të përfitueseve, si dhe mbështetje të drejtpërdrejtë për zhvillimin e aktiviteteve të tyre ekonomike.

Projekti financohet nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe implementohet nga Fondacioni Jahjaga, me bashkëfinancim dhe mbështetje nga Komuna e Lipjanit.



# PËR NDER TË EPOPESE SË UÇK-SË, FËMIJËT E ÇERDHE SË GADIMES VIZITOJNË KOMUNËN E LIPJANIT

Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e Epopesë së UÇK-së, fëmijët e çerdhës së Gadimes realizuan vizitë në Komunën e Lipjanit.

Gjatë kësaj vizite ata u pritën nga Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, Kryesuesi i Kuvendit, z. Daut Azemi, si dhe Drejtori i Drejtorisë së Arsimit, z. Rasim Hasani.

Vizita u zhvillua në një atmosferë të ngrohtë ku fëmijët së bashku me edukatorët e tyre patën mundësinë të njihen nga afër me institucionet komunale dhe punën e tyre.



# KOMUNA E LIPJANIT NDAN MIRËNJOHJE PËR MËSIMDHËNËSIT E DALLUAR

Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 7 Marsit, Ditës së Mësuesit, Drejtoria Komunale e Arsimit në Lipjan organizoi ceremoninë e ndarjes së mirënjohjeve për mësimsdhënësit e dalluar të vitit shkollor 2025/2026.

Me këtë rast u ndanë mirënjohje për mësimsdhënësit më të dalluar në secilën shkollë të komunës, duke vlerësuar kontributin dhe përkushtimin e tyre në procesin edukativo arsimor.

Mësimsdhënësja e dalluar për Komunën e Lipjanit për vitin shkollor 2025/2026 u shpall Besa Tmava Bërbatovci, e cila njëkohësisht është nominuar për çmimin “Shaban Jashari”.

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit, z. Rasim Hasani, theksoi se roli i mësimsdhënësit është thelbësor në edukimin dhe formimin e brezave të rinj, duke e cilësuar atë si një ndër shtyllat kryesore të zhvillimit të shoqërisë. Ai shtoi se vlerësimi dhe mbështetja për mësimsdhënësit duhet të jenë prioritet për çdo shoqëri që synon progres dhe të ardhme më të mirë.

Komuna e Lipjanit mbetet e përkushtuar në vlerësimin dhe mbështetjen e mësimsdhënësve për rolin e tyre të rëndësishëm në edukimin e gjeneratave të reja.



# KRYETARI AHMETI BËN HOMAZHE PËR NDER TË EPOPESE SË UÇK-SË

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorë në kuadër të shënimit të 28 vjetorit të Epopesë së UÇK-së, ka bërë homazhe dhe ka vendosur buqetë me lule pranë shtatores së komandantit legjendar Adem Jashari, në sheshin e qytetit të Lipjanit.

Kryetari Ahmeti theksoi se përvjetorët e Epopesë së UÇK-së nuk janë vetëm momente përkujtimi, por edhe një mundësi për reflektim mbi përgjegjësinë që kemi për të ardhmen e shtetit dhe ndërtimin e tij.

“Sakrifica e komandantit legjendar Adem Jashari dhe familjes së tij mbetet simbol i heroizmit dhe përkushtimit të palëkundur për lirinë dhe atdheun. Kjo sakrificë përfaqëson një mesazh të përherëshëm për unitetin dhe dashurinë ndaj vendit. Brezat e sotëm dhe ata që vijnë kanë përgjegjësinë të ruajnë dhe të përcjellin vlerat e luftës për liri duke kontribuar në forcimin e shtetit dhe në ndërtimin e një të ardhmeje të qëndrueshme mbi idealet dhe sakrificën e dëshmorëve”, tha Kryetari z. Imri Ahmeti.

Përluajë përjetësisht për heroizmin dhe sakrificën e Familjes Jashari!

Lavdi e përjetshme komandantit legjendar Adem Jashari!



**KRYETARI I KOMUNËS SË LIPJANIT, Z. IMRI AHMETI, KA URUAR TË GJITHË MËSIMDHËNËSIT ME RASTIN E 7 MARSIT DITËS SË MËSUESIT, DUKE VLERËSUAR KONTRIBUTIN E TYRE NË EDUKIMIN DHE FORMËSIMIN E BREZAVE TË RINJ.**

# *Urime 7 Marsi Dita e Mësuesit!*

*Kryetari i Komunës së Lipjanit*

*Imri Ahmeti*



Të nderuar mësimdhënës,

7 Marsi Dita e Mësuesit, është një ditë e veçantë për të gjithë ne, sepse na kujton rolin dhe kontributin e pazëvendësueshëm në edukimin dhe formësimin e brezave të rinj. Kjo datë shënon gjithashtu një moment të rëndësishëm në historinë e arsimit shqiptar, me hapjen e shkollës së parë shqipe më 7 mars 1887 në Korçë.

Me këtë rast shpreh mirënjohjen dhe respektin tim të sinqertë për të gjithë mësimdhënësit, të cilët me përkushtim, vullnet dhe dashuri për dijen punojnë çdo ditë në edukimin dhe arsimimin e gjeneratave të reja.

Urime 7 Marsi, Dita e Mësuesit!

Imri Ahmeti

Kryetari i Komunës së Lipjanit

KRYETARI I KOMUNËS SË LIPJANIT, Z. IMRI AHMETI, KA URUAR TË GJITHA GRATË ME RASTIN E DITËS NDËRKOMBËTARE TË GRUAS, DUKE SHPREHUR RESPEKT DHE MIRËNJOHJE PËR ROLIN DHE KONTRIBUTIN E TYRE TË RËNDËSISHËM NË FAMILJE DHE NË SHOQËRI.

Urime



Marsi  
Dita e Gruas

Kryetari i Komunës së Lipjanit

Imri Ahmeti



Urime 8 Marsin Ditën Ndërkombëtare të Gruas!

Në këtë ditë të veçantë shprehim respektin dhe mirënjohjen më të thellë për të gjitha gratë, nënat, motrat dhe vajzat për rolin dhe kontributin e tyre të pazëvendësueshëm në familje dhe në shoqëri.

Me përkushtimin, punën dhe sakrificën e tyre të përditshme, gratë janë shtyllë e fuqishme e familjes dhe një forcë e rëndësishme në zhvillimin dhe përparimin e shoqërisë sonë.

Urime 8 Marsin, me respekt dhe mirënjohje për të gjitha gratë!

Imri Ahmeti

Kryetari i Komunës së Lipjanit

# KOMITETI PËR KOMUNITETE KA ZHVILLUAR PUNIMET E MBLEDHJES SË 2-TË ME RADHË

Në sallën e takimeve të Komunës së Lipjanit, u mbajt mbledhja e 2-të e Komitetit për Komunitete (KK), e udhëhequr nga kryesuesi, z. Alush Bikliqin, ku u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës.

Gjatë takimit u diskutua dhe u miratua Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2026.

Në përfundim të mbledhjes, anëtarët e Komitetit shqyrtuan disa çështje dhe kërkesa të ndryshme të pranuar nga komunitetet.



# KRYETARI AHMETI PRET NË TAKIM MINISTREN KUSARI-LILA, DISKUTOJNË BASHKËPUNIMIN INSTITUCIONAL

Kryetari i Komunës së Lipjan, z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim ministren e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, znj. Mimoza Kusari-Lila, me të cilën kanë diskutuar për thellimin e bashkëpunimit institucional ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendror. Me këtë rast kryetari Ahmeti falënderoi ministren për vizitën, duke theksuar se Komuna e Lipjanit e ka prioritet zhvillimin e Parkut të Biznesit në Qylagë si një ndër projektet kryesore për zhvillimin ekonomik lokal.

“Përmes investimeve të vazhdueshme në këtë park, synojmë të krijojmë kushte sa më të favorshme për investitorët dhe bizneset prodhuese. Prioritet i yni mbetet tërheqja e sa më shumë kompanive që do të kontribuojnë në hapjen e vendeve të reja të punës dhe në rritjen e zhvillimit ekonomik në komunën tonë”, tha Kryetari, z. Imri Ahmeti.

Ndërsa ministrja Kusari-Lila falënderoi kryetarin Ahmeti për pritjen dhe vlerësoi krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e bizneseve në Lipjan. Ajo theksoi gatishmërinë për bashkëpunim të mëtejshëm ndërinstitucional, me qëllim fuqizimin e Parkut të Biznesit dhe mbështetjen e investimeve të reja.

Pas takimit kryetari Ahmeti dhe ministrja Kusari-Lila vizituan Parkun e Biznesit në Qylagë, ku panë nga afër zhvillimet dhe aktivitetin e bizneseve që tashmë kanë filluar operimin në këtë zonë. Ndër bizneset që operojnë në këtë park është edhe kompania Liga Steel, e cila aktualisht ka nisur procesin e prodhimit.

Në fund të takimit palët u dakorduan për vazhdimin e investimeve dhe thellimin e bashkëpunimit ndërmjet komunës dhe ministrisë, me fokus në zhvillimin ekonomik.



**KRYETARI I KOMUNËS SË LIPJANIT, Z. IMRI AHMETI, KA URUAR TË GJITHË QYTETARËT ME RASTIN E FESTËS SË FITËR BAJRAMIT, DUKE THEKSUAR RËNDËSINË E SOLIDARITETIT DHE RESPEKTIT NDAJ NJËRI-TJETRIT.**



# URIME FITËR BAJRAMIN!

*Kryetari i Komunës së Lipjanit*

*Imri Ahmeti*

Të dashur qytetarë,

Në këtë ditë feste të Fitër Bajramit, ju uroj nga zemra shëndet paqe dhe gëzim në familjet tuaja. Uroj që kjo festë t'ju gjejë pranë më të dashurve tuaj.

Fitër Bajrami është më shumë se një festë, është një kujtesë për të treguar solidaritet e mirësi, për të ndihmuar ata që kanë nevojë dhe për të ndarë gëzimin së bashku me familjen dhe miqtë.

Le ta shfrytëzojmë këtë festë për të forcuar unitetin mes nesh dhe për të ndërtuar një shoqëri që respekton njëri-tjetrin.

Urime Fitër Bajramin!

Imri Ahmeti

Kryetari i Komunës së Lipjanit

# NËNKRYETARI BYTYQI NDERON ME HOMAZHE HEROIN E KOMBIT, ISMET ASLLANI

Nënkryetari i Komunës së Lipjanit z. Diamant Bytyqi, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, me rastin e 27 vjetorit të rënies heroike të Heroit të Kombit Ismet Asllani, ka bërë homazhe dhe ka vendosur buqeta me lule pranë shtatores, në shenjë respekti dhe mirënjohjeje për veprën e tij.

Me këtë rast nënkryetari Bytyqi, theksoi se idealet për të cilat luftoi Ismet Asllani dhe bashkëluftëtarët e tij për një shtet të pavarur dhe të zhvilluar mbeten udhërrëfyes dhe përgjegjësi e përhershme për të gjithë.

Lavdi Heroit të Kombit, Ismet Asllani!



# U MBAJT MBLEDHJA E JASHTËZAKONSHME E KUVENDIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Kuvendi i Komunës së Lipjanit, i udhëhequr nga Kryesuesi, z. Daut Azemi, zhvilloi punimet e mbledhjes së jashtëzakonshme, në të cilën u shqyrtuan dhe u miratuan të gjitha pikat e rendit të ditës, të propozuara për këtë seancë. Gjatë punimeve të kësaj seance u miratuan këto pika të rendit të ditës:



# DREJTORI I DKA-SË PRET NË TAKIM NXËNËSIT NGA SHKUPI NË KUADËR TË PROJEKTIT “VOICES FOR PEACE - THE ART OF LIVING TOGETHER”

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit, z. Rasim Hasani, së bashku me shefin e kabinetit z. Avni Jashari, kanë pritur në takim nxënësit dhe përfaqësuesit e institucioneve arsimore nga Shkolla EMUC “8 Shtatori”, Shkup, të cilët po marrin pjesë në projektin ndërkombëtar “Voices for Peace - The Art of Living Together”, në kuadër të programit Supershkolla – RYCO.

Me këtë rast drejtori Hasani, përgëzoi nxënësit për angazhimin dhe përkushtimin e treguar në këtë projekt, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit dhe dialogut ndërkulturor në ndërtimin e një shoqërie të qëndrueshme.

“Ky projekt përfaqëson një shembull të mirë të bashkëpunimit ndërmjet të rinjve dhe institucioneve arsimore në rajon.

Angazhimi juaj në promovimin e paqes, mirëkuptimit dhe bashkëjetesës është një vlerë e çmuar për shoqërinë tonë. Sa i përket Komunës së Lipjanit, ajo karakterizohet nga pasuri të shumta natyrore dhe një zhvillim i qëndrueshëm në fushën e arsimit”, tha drejtori, z. Rasim Hasani.

Në këtë aktivitet marrin pjesë nxënës nga Shkolla EMUC “8 Shtatori” nga Shkupi dhe IAAP “Adem Gllavica” nga Lipjani, të cilët kanë realizuar modulin e parë të projektit të fokusuar në ndërtimin e paqes në shoqëri multietnike dhe multikulturore. Gjatë këtij moduli janë trajtuar tema të rëndësishme si menaxhimi i konflikteve, dëgjimi aktiv dhe komunikimi jo i dhunshëm.



# KRYETARI AHMETI PRET NË TAKIM KRYETARIN E KOMUNËS SË DRAGASHIT

Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim Kryetarin e Komunës së Dragashit, z. Bexhet Xheladini, me të cilin kanë bashkëbiseduar për çështje që lidhen me qeverisjen lokale.

Kryetari Ahmeti falënderoi homologun e tij për vizitën dhe theksoi rëndësinë e shkëmbimit të përvojave ndërmjet dy komunave, të cilat ndërlidhen me qeverisjen lokale.

“Gjatë këtyre viteve jemi fokusuar në realizimin e projekteve konkrete që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe në krijimin e kushteve më të favorshme për zhvillim ekonomik. Në këtë drejtim do të vazhdojmë me investime të qëndrueshme në infrastrukturë, arsim dhe shëndetësi”, tha Kryetari z. Imri Ahmeti.

Nga ana tjetër Kryetari i Komunës së Dragashit z. Bexhet Xheladini, falënderoi Kryetarin Ahmeti për mikpritjen dhe vlerësoi zhvillimet e arritura në Komunën e Lipjanit, e cila gjatë këtyre viteve ka shënuar progres të dukshëm në realizimin e projekteve në shërbim të qytetarëve, duke u bërë një shembull i mirë i qeverisjes lokale.



# KPF MBAN MBLEDHJEN E TRETË ME RADHË



## KPF mban mbledhjen e tretë me radhë

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), i udhëhequr nga Kryesuesi i Kuvendit, z. Daut Azemi, ka mbajtur mbledhjen e tretë me radhë, ku janë diskutuar të gjitha pikat e rendit të ditës të propozuara për këtë mbledhje.

Gjatë këtij takimi, Kryesuesi i Kuvendit z. Daut Azemi, përveç pikave të propozuara, ka prezantuar edhe një pikë shtesë për diskutim.

Pas diskutimeve, anëtarët e KPF-së kanë rekomanduar të gjitha pikat për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet të martën, më 31 mars 2026.

# NËNKRYETARI BYTYQI NËNSHKRUAN MEMORANDUM MIRËKUPTIMI PËR MBËSHTETJEN E STREHIMORES PËR GRATË DHE FËMIJËT

Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, ka marrë pjesë në ceremoninë zyrtare të nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet komunave të rajonit të Prishtinës dhe Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve në Prishtinë, e organizuar nga OSBE.

Me këtë rast Nënkryetari Bytyqi, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional në mbështetje të viktimave të dhunës.

“Komuna e Lipjanit mbetet e përkushtuar në ofrimin e mbështetjes së vazhdueshme për kategoritë më të ndjeshme të shoqërisë. Ky memorandum forcon bashkëpunimin dhe siguron qëndrueshmëri në ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore”, tha nënkryetari z. Diamant Bytyqi. Ky memorandum synon forcimin e bashkëpunimit ndërmjet komunave dhe strehimores, me fokus në sigurimin e mbështetjes financiare të qëndrueshme për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Komuna e Lipjanit mbetet e angazhuar në mbështetjen e mekanizmave që kontribuojnë në mbrojtjen dhe fuqizimin e viktimave, duke garantuar qasje në shërbime të sigurt dhe të qëndrueshme.



# U MBAJT MBLEDHJA E 5-TË ME RADHË E KUVENDIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Kuvendi i Komunës së Lipjanit, i udhëhequr nga Kryesuesi, z. Daut Azemi, zhvilloi punimet e mbledhjes së 5-të me radhë, në të cilën u shqyrtuan dhe u miratuan të gjitha pikat e rendit të ditës, të propozuara për këtë seancë.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, gjatë kësaj seance ka dhënë sqarime për të gjitha pyetjet dhe çështjet e ngritura nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Gjatë punimeve të kësaj seance u miratuan këto pika të rendit të ditës





## **Komuna e Lipjanit – Zyra për informim**



<https://lipjan.rks-gov.net/>



[infokomuna.lipjan@rks-gov.net](mailto:infokomuna.lipjan@rks-gov.net)



0 800 14 000 / 038 200 41 508